



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2023:146005

Datë: 22.04.2024

Numri i dokumentit: 05601915

P.nr.2443/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRISHTIË – DEGA FUSHË KOSOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, sipas Gjyqtares Laura Hoti Statovci, në lëndën penale të akuzuarit E. T. nga F. K., i akuzuar për veprën penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par 2 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.3571/2023 të datë 04.07.2023 në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 19.04.2024, në praninë e Prokurorit të Shtetit Nazmi Krasniqi dhe të akuzuarit E. T., me datë 19.04.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 22.04.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri E. T., i biri i O. dhe nëna Z...., e gjinisë Kopili, i lindur me, në B....., me vendbanim në Fushë Kosovë, Rr. K. F., me numër personal, të dhëna këto të vërtetuara nga dokumenti i letërnjoftimit të lëshuar nga MPB, ka të kryer shkollën fillore, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, Ashkali, Shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Ekziston dyshimi i bazuar mirë se me datë 10.09.2022, rreth orës 00:00, në rrugën e P..., në QKMF-F. K. i pandehuri E. T., pa autorizim ka poseduar narkotik, substanca psikotrope ose analoge të shpallura të rrezikshme e në kundërshtim me nenin 9 dhe 14 të Ligjit për Barnat Narkotike, Substanca Psikotrope dhe Prekursorë Nr.02/L-128, dhe atë narkotikun e llojit Marihuanë, në atë mënyrë, që natën kritike, pas qe i pandehuri shkon për kontroll mjekësorë në QKMF në Fushe Kosove, dhe gjatë trajtimit mjekësor nga personeli mjekësor tek i pandehuri, vërehet substancë e dyshuar narkotike, dhe pas arritjes së policisë në vend ngjarjes, gjata kontrollit në trupin e të pandehurin nga ana e zyrtarëve policor është gjetur substancë narkotike e dyshuar e llojit Marihuanë me peshë 1.21 gram dhe një shishe të vogël qelqi me një sasi lëngu të pa njohur, të cilat janë sekuestruar nga ana e zyrtarëve policor, ku pas ekzaminimit laboratorik të narkotikut në bazë të raportit të ekspertimit Nr.ref: AKF/2023-0081/23-69, të datës 03.05.2023, ka rezultuar të jetë substancë narkotike e llojit Kanabis (Marihuanë), që përmban Tetrahidrokanabinol (THC), me peshë neto të përgjithshme: 0.94 ± 0.0001 gram.

- Me këto veprime, i pandehuri, ka kryer veprën penale *Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge*, nga neni 269 par.2 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 38, 69, 70, 71, 81 dhe 82 të KPRK-së neneve 240, 241, 242 par. 1 dhe 6, 358, 359, 360, 361 dhe 364, 498, 499 të KPPRK-së, të pandehurit i shqipton:

VËREJTJE GJYQËSORE

Te pandehurit i bëhet me dije se ka kryer veprë penale të dëmshme dhe nëse serish kryen ndonjë veprë të tillë, gjykata do të shqiptoi sanksionin penal.

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës gjyqësore të paguaj shumën prej 20 (njëzet) Euro në emër të paushallit gjyqësor, si dhe shumën prej 20 (njëzet) Euro në emër të kompensimit të viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konfiskohet substanca narkotike e llojit Kanabis (Marihuanë), që përmban Tetrahidrokanabinol (THC), me peshë neto të përgjithshme: 0.94 ± 0.0001 gram dhe urdhërohet asgjësimi i saj, nga Policia e Kosovës në bashkëpunim me Prokurorinë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur Aktakuzë PP.II.nr.3571/2023 të datë 04.07.2023, ndaj të akuzuarit E. T. për shkak të dyshimit të bazuar mire se ka kryer veprën penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së, 06/L-074).

Gjykata, në këtë çështje penalo juridike ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 19.04.2024, në prani të Prokurorit të Shtetit, Nazmi Krasniqi dhe të akuzuarit E.T., ku i akuzuari ku i njëjti u njoftuan me të drejtat e tij, me aktakuzën dhe provat kundër tij.

Prokurori i shtetit para leximit të aktakuzës në seancën e shqyrtimit fillestarë ka bërë rikualifikimin e veprës penale ashtu që duke ju referuar akt-ekspertimit nga i cili raport rezulton se sasia e narkotikut që është gjetur te i pandehuri ka qenë 0.94 gram dhe duke qenë se i pandehuri më parë nuk ka qenë i dënuar për këtë lloje të veprës penale nga kualifikimi juridik Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par 1 kualifikohet vepra penale në Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par 2.

Seanca ka vazhduar me leximin e aktakuzës nga prokurori i shtetit ku pas leximit të saj i pandehuri u deklarua se e pranojnë fajësinë për veprën penale për të cilat akuzohet sipas aktakuzës.

Pas deklarimit të akuzuarit, mendimit të prokurorit se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, pasi që një pranim i tillë bëhet në mënyrë vullnetare dhe se është i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë si dhe ky pranim i fajësisë është në përputhje të plotë me provat dhe gjendjen faktike si ne aktakuzë. Gjykata konstatoj se i akuzuari e pranon fajësinë në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë presion, i akuzuari është e vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë për të cilat është njoftuar nga Gjykata, si dhe te gjitha kërkesat nga neni 242 par. 2 te KPPRK-se janë përmbushur. Ashtu që gjykata aprovon deklarimin për pranimin e fajësisë nga ana e te akuzuarit.

Duke pas parasysh se gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 357 par.1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 242 par. 6 lidhur me par. 2 të KPPRK-së, atëherë ne këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklaramentit të akuzuarit se e pranon fajësinë në kuptim të nenit 242 par. 6 të KPPRK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me faktet e ofruara ne shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurit E. T. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par 2.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se i akuzuari e ka kryer veprën me dashje, ndërsa gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të akuzuarit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese ne kuptim të nenit 70 të KPRK-se. Kështu si rrethana lehtësuese për të akuzuarin, gjykata ka vlerësuar faktin se i njëjti më parë kishte sjellje korrekte dhe nuk kishte rënë asnjëherë ne konflikt me ligjin. Gjithashtu i akuzuari ka treguar sjellje korrekte gjatë shqyrtimit gjyqësor duke pranuar fajësinë, duke u ndier i përgjegjshëm për veprimet e tij dhe duke shprehur keqardhje për veprën që e ka kryer. Të gjitha këto rrethana kjo gjykatë i ka pranuar si rrethana lehtësuese ne dobi të akuzuarit. Rrethana rënduese Gjukata nuk gjeti

Andaj, duke vlerësuar këto rrethana, Gjukata ne kuptim të nenit 82 të KPRK-se të akuzuarin e gjykoi si ne dispozitiv të këtij aktgjykimit, me të cilin do të arrihet edhe qëllimi i dënimit.

Gjukata ka ardhur ne përfundim se vërejtja shqiptuar të akuzuarit është ne përputhje me shkallen e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjukata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbejë për arritjen e qëllimit të dënimit ne pengimin e të pandehurit ne kryerjen e veprave penale ne të ardhmen veçanërisht llojin e njëjte të veprës penale, por ai do të ndikoj edhe si preventive e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale ne përputhje me nenin 38 të KPPRK-se.

Duke u bazuar ne nenin 449 par. 2 pika 2.6 dhe 452 par.1 të KPPRK-se si dhe në bazë të nenit 36 par.3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit nr.08/L-109, Gjukata ka vendosur për shpenzimet e procedurës penale në shumën e përgjithshme prej 40 Euro.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 364, 498, 499 të KPPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA FUSHË KOSOVË,
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL
P.nr.2443/23 datë 22.04.2024

Gjyqtarja e vetme Gjykuese

Numri i lëndës: 2023:146005
Datë: 22.04.2024
Numri i dokumentit: 05601915

Laura Hoti Statovci

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimet të të njëjtit. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.